

Legji
24.11.2015




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 931, datë 18.11.2015

PËR



NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.718, DATË 29.10.2004,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE
TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT",
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1 dhe 28, pika 1, të ligjit nr.157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutës së Këshillit të Sigurimit ("Lista e OKB-së"), që i bashkëlidhet vendimit nr.718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar, bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës "A", "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me Talibanët", çregjistrohet individi i renditur në shkronjën "a", të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për Talibanët.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I PUNËVE
TË JASHTME

DITMIR BUSHATA
D. Bushata

**AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI-
FINANCUES TË TERRORIZMIT**

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (“LISTA E OKB-
së”)

**A. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME
TALIBANËT**

a) Lista e ndryshuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë
me Talibanët”;

1. TOREK; AGHA

Shënim: Gjeneralitetet e tjera për personin emri i të cilit është radhitur më sipër,
mbahet në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

NR.PROT.5329/1
DATË 24.11.2015

MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME
MINISTRISË SË FINANCAVE
SHISH
PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI

